



Royal Free London
NHS Foundation Trust

Proteina Plazmatike A e Lidhur me Shtatzëninë - (PAPP-A)

Informacion për pacientët

Kjo fletëpalosje ju është dhënë sepse analiza e fundit e kombinuar e gjakut tregoi se keni nivele të ulëta të PAPP-A.

Së pari, ju lutem mos u shqetësoni. Në këtë fletëpalosje përshkruhen disa nga informacionet më të rëndësishme dhe mënyra se si ne do t'ju mbështesim gjatë shtatzënisë. Është e rëndësishme të theksohet se duke treguar më shumë kujdes dhe duke dhënë mbështetje shtesë, shumica e shtatzënive me nivele të ulëta PAPP-A rezultojnë në lindjen e shëndetshme të foshnjave dhe nëna të shëndetshme.

Çfarë është PAPP-a?

PAPP-A do të thotë Proteina Plazmatike A e Lidhur me Shtatzëninë, e cila është një proteinë e prodhuar nga placenta - organi që siguron oksigjen dhe lëndë ushqyese për fëmijën tuaj ndërsa rritet. PAPP-A është një nga hormonet që matet gjatë tremujorit të parë në testin e kombinuar.

Nivelet e ulëta të PAPP-A gjenden tek rreth 5% e të gjitha shtatzënive. Hulumtimet tregojnë se tek disa gra me nivele të ulëta të PAPP-A, placenta duhet të punojë më shumë se tek shtatzënitë me nivele më të larta të PAPP-A, dhe se si rezultat shtatzënia mund të ndikohet nga:

- Foshnjat me peshë të ulët
- Tension i lartë i gjakut dhe proteina në urinë, e njohur si pre-eklampsia.

Rreziku i këtyre komplikimeve është i vogël. Sidoqoftë, kur gjenden rezultate të tilla, ne ofrojmë një monitorim më të afërt të nënës dhe foshnjës për t'u siguruar që të dyja të jenë sa më të sigurtat. Monitorimi shtesë zakonisht përfshin monitorim shtesë të tensionit të gjakut dhe kontrole shtesë të rritjes së foshnjës.

Çfarë do të thotë kjo për shtatzëninë time?

Tani që keni marrë rezultatet e analizave të gjakut, do t'ju caktohet një konsultë me telefon. Kjo do t'ju japë mundësinë të bëni çdo pyetje që mund të keni, gjithashtu do t'ju japë kohë për të diskutuar mbi planin e kujdesit për pjesën tjetër të shtatzënisë me ekipin tuaj të mamive që kujdesen për ju.

Gjatë skanimit rutinë 20-javor, do t'ju ofrohet gjithashtu një matje me Doppler e arteries së mitrës. Kjo është një matje që na jep informacion në lidhje me fluksin e gjakut nga ju (nëna) tek fëmija juaj (në mitër).

Përveç kësaj, do t'ju ofrohen një sërë skanimesh për të monitoruar rritjen e foshnjës tuaj dhe për të vlerësuar vëllimin e lëngut amniotik (uji që rrethon foshnjën). Këto skanime dhe matje shtesë na ofrojnë informacion të rëndësishëm i cili mund të na ndihmojë për t'ju mbështetur ju dhe fëmijën tuaj gjatë shtatzënisë.

Gjatë shtatzënisë tuaj ne gjithashtu do të vazhdojmë të kontrollojmë tensionin e gjakut dhe urinën tuaj gjatë kontrolleve rutinë para lindjes. Kjo është e nevojshme në mënyrë që çdo ndryshim të mund të zbulohet në një fazë të hershme.

Çfarë vijon më pas?

Nëse nuk jeni alergjike ndaj aspirinës dhe nuk keni ndonjë nga kushtet e renditura më poshtë, ne do t'ju rekomandojmë që të merrni aspirinë gjatë shtatzënisë. Kjo për shkak se aspirina mund të zvogëlojë rrezikun e disa prej komplikimeve të shtatzënisë (ju lutemi shikoni detajet në pjesën "Pse duhet të marr aspirinë?" në këtë fletëpalosje).

Ne ju rekomandojmë që të merrni gjithsej 150mg aspirinë një herë në ditë. Është mirë që të merrni aspirinë një herë në ditë pas vaktit të darkës. Shumë aspirina vijnë në tableta 75 mg, prandaj do t'ju duhet të merrni dy tableta për të arritur dozën 150 mg.

Kushtet që tregojnë se nuk duhet të merrni aspirinë:

- Nëse keni / keni pasur një histori të astmës
- Nëse keni ulcerë peptike aktive ose të mëparshme - plagë që zhvillohen në mukozën e stomakut
- Nëse keni ndonjë çrregullim të koagulimit të gjakut si hemofilia
- Nëse jeni nën 16 vjeç, për shkak të rrezikut të sindromës Reye
- Nëse keni përjetuar goditje të rëndë kardiake.

Kur duhet ta filloj dhe ta ndaloj marrjen e aspirinës?

Ju duhet të filloni të merrni aspirinë nga tani deri në 36 javë të shtatzënisë. Nëse filloni lindjen përpara javës së 36-të, ju lutemi ndaloni menjëherë marrjen e aspirinës dhe njoftoni maminë tuaj.

Pse duhet të marr aspirinë?

Hulumtimet tregojnë se marrja e aspirinës mund të ndihmojë në zvogëlimin e rrezikut të zhvillimit të pre-eklampsisë (një gjendje gjatë shtatzënisë që përfshin tension të lartë të gjakut dhe proteina në urinë) e cila zhvillohet tek gratë që anë në rrezik, duke përmirësuar formimin e placentës.

Marrja e aspirinës ndihmon në përmirësimin e fluksit të gjakut tek fëmija juaj gjatë fazave të hershme të shtatzënisë, që do të thotë se fëmija juaj mund të zhvillohet plotësisht. Pra, marrja e aspirinës mund të ndihmojë në zvogëlimin e rrezikut për të pasur një fëmijë të vogël - veçanërisht nëse keni pasur një fëmijë të vogël në shtatzënitë e mëparshme.

A ka ndonjë gjë që mund të bëj për ta ndihmuar fëmijën tim të rritet mirë?

Nëse pini duhan, është jashtëzakonisht e rëndësishme që ta ndaloni. Pirja e duhanit mund të ndikojë në funksionin e placentës dhe të dëmtojë rritjen e foshnjës. Mamia juaj mund t'ju referojë për t'ju ndihmuar për të lënë duhanin.

Me kë mund të flas për më shumë informacion?

Ne e kuptojmë se marrja e lajmit se keni nivele të ulëta PAPP-A mund të jetë shqetësues. Ju lutemi të jeni të sigurt se kjo zakonisht nuk do të thotë se do të ketë një problem me shtatzëninë tuaj. Ne ju sigurojmë se me monitorimin shtesë që është përmendur në këtë fletëpalosje, shumica e shtatzënive rezultojnë në lindjen e foshnjave të shëndetshme.

Ju do të keni mundësinë të diskutoni më tej në lidhje me këtë gjatë konsultimit tuaj me telefon. Megjithatë, nëse dëshironi ta diskutoni më tej këtë, duhet të kontaktoni maminë që iu është caktuar.

Më shumë informacion

Për më shumë informacion rreth shërbimit në Royal Free London, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit: www.royalfree.nhs.uk

Komentet tuaja

Në rast se keni ndonjë koment mbi këtë fletëpalosje ose për një listë të referencave për të, ju lutem dërgoni email në adresën:

rf.communications@nhs.net

Formate Alternative

Kjo fletëpalosje është gjithashtu në dispozicion me germa të mëdha. Në rast se keni nevojë për këtë fletëpalosje në një format tjetër - për shembull Braille, një gjuhë tjetër përveç Anglishtes ose audio - ju lutemi flisni me një anëtar të personelit.

© Royal Free London NHS Foundation Trust

Service: Maternity

Leaflet reference: RFL914SQ

Version number: 1

Approval date: March 2023

Review date: March 2025

www.royalfree.nhs.uk